

## KONFERENCA E BUJANIT GUR THEMELI I SHTETËSISË SË KOSOVËS

Alban DOBRUNA  
Instituti i Historisë "Ali Hadri"  
Prishtinë

Punim studimor

**Përmbajtja e shkurtër:** Në prill të vitit 1941, shtetet e bllokut fashist sulmuan Jugosllavinë, duke e shpërbërë dhe copëtuar atë. Fatin e Jugosllavisë e përjetuan edhe trevat shqiptare që ishin nën sundimin e saj, ngase ato u ndanë në tri zona pushtimi: gjermane, italiane dhe bullgare. Në këtë punim shkencor do të përpiqem të elaboroj fillimin e konfliktit ndërmjet pushtuesve fashistë dhe bashkëpunëtorëve të tyre, si dhe dëshirën e popullit shqiptar në përgjithësi, e në veçanti atij të Kosovës, për çlirimin dhe zgjidhjen e çështjes kombëtare. Organizimi më i rëndësishëm i shqiptarëve të Kosovës, gjatë Luftës së Dytë Botërore, është Konferenca Bujanit, mbajtur më 31 dhjetor 1943 dhe 1 dhe 2 janar 1944. Në Rezolutën e saj, përveç tjerash, thuhet se populli shqiptar i Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit, shpreh vullnetin e tij të lirë që, pas Luftës, Kosova t'i bashkohet shtetit amë – Shqipërisë.

**Fjalët kyçe:** Lufta e Dytë Botërore, Konferenca e Bujanit, Kosova, Shqipëria etj.

Në prill të vitit 1941, shtetet e bllokut fashist sulmuan Jugosllavinë, duke e copëtuar atë.<sup>1</sup> Fatin e saj e përjetuan edhe trevat shqiptare që ishin

---

<sup>1</sup> Xhelal Gjeçovi, "Çështja Kombëtare Shqiptare në vitet e Luftës së Dytë Botërore", *Studime historike*, 3-4, (2005), 147; Muharrem Dezhgiu, "Kombi shqiptar në planet

nën sundimin jugosllav. Në kuadër të pushtimit nazifashist, viset shqiptare u ndanë në tri zona pushtimi: gjermane, italiane dhe bullgare.<sup>2</sup> Edhe pse bashkimi u bë nën kapelën fashiste, megjithatë për popullsinë shqiptare në Kosovë dhe në Maqedoninë Perëndimore kishte rëndësi të madhe historike. Forcat pushtuese vendosën që qeverisja lokale në rajonet e populluara nga shqiptarë të drejtohej nga shqiptarët,<sup>3</sup> ndërsa gjuha shqipe u shpall si gjuhë zyrtare bashkë me atë italiane. Për herë të parë u hapën shkolla fillore dhe të mesme në gjuhën shqipe, u legalizua përdorimi i simboleve kombëtare, u lejuan gazetat shqip, u lejua shënimi i festave kombëtare shqiptare.<sup>4</sup> Mirëpo pavarësisht gjithë këtyre të drejtave që fituan shqiptarët, copëtimi i Kosovës në tri zona pushtuese kishte si qëllim shfrytëzimin ekonomik si dhe shtypjen nacionale të popujve të pushtuar dhe pikërisht me këtë pushtim dhe ndarjen në zona interesi, filloi një periudhë e vështirë për shqiptarët.<sup>5</sup> Menjëherë pas pushtimit të Kosovës filluan të shfaqeshin mosmarrëveshje në mes të pushtuesve sa i përket vijës së demarkacionit në mes tyre, sepse secila palë dëshironte të merrte sa më shumë sipërfaqe. Këto konflikte filluan të lindin edhe ndërmjet bashkëpunëtorëve pushtues si shqiptaromëdhenjve, serbomëdhenjve dhe bullgaromëdhenjve.

Gjendja dhe pozita e Kosovës nën pushtimin nazifashist ka qenë gjithashtu e rëndë. Brutaliteti i regjimeve të pushtuesve është shprehur

---

strategjike të fuqive ndërluftuese gjatë Luftës II Botërore”, *Studime historike*, 3-4, (2005), 160: Lefter Nasi, “Kosova dhe problemi kombëtar në vitet 1941-1943”, *Kosova*, 28, (2006), 213.

<sup>2</sup> *Arkivi Qendror Shqiptar* (më tej: *AQSH*), Fondi (F). 266, Ministria e Tokave të Lirume, f.1-25; Kuadri i Personelit të Nënprefekturave: Dragash, Rahovec, Suharekë, Gjakovë, Istog, Drenicë, Plavë, Cucinjë, Rozhajë, Gjilan, Ferizoviq, Tetovë, Gostivar, Kërçovë, Strugë, Rekë, Carisver (Prespë e madhe): *AQSH*, F. 266, Ministria e Tokave të Lirume, V. 1943, Nr. 32, f. 2: Koncept Mbretëria e Shqiptare Komisarati i Naltë Civil për Kosovë, Dibër e Strugë. Prizren 29 gen 1943; Muharrem Dezhgiu, ”Përpjekjet e forcave politike shqiptare për bashkëpunim gjatë Luftës së Dytë Botërore”, *Studime historike*, 1-2, (2000), 189: Fehmi Rexhepi, “Lufta e shqiptarëve për vetëvendosje e bashkim kombëtar gjatë Luftës së Dytë Botërore”, *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore (Përmbledhje studimesh)*, (Prishtinë: Instituti i Historisë”Ali Hadri”-Prishtinë, Instituti i Historisë-Tiranë, 2014), 136-137.

<sup>3</sup> Stefan Karastojanov, *Kosova (Një analizë gjeopolitike)*, (Shkup: Serembe, 2007), 152.

<sup>4</sup> Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*, (Tiranë: 55, 2006), 450: Valentina Duka, *Historia e Shqipërisë 1912-2000*, (Tiranë: Kristalina-KH, 2007), 213.

<sup>5</sup> Emin Pllana, “Vuçiterna me rrethinë në kuadrin e sistemit pushtues fashist 1941-1945”, *Kosova*, Nr. 7, (1978), 297.

edhe në këtë trevë.<sup>6</sup> Në kohën e Luftës së Dytë Botërore nga ana e pushuesve nazifashisë janë arrestuar, rrahur dhe internuar shumë shqiptarë, porse ndryshimi i situatës së brendshme dhe asaj ndërkombëtare e dobësoi besimin e tyre ndaj pushtuesit. Ky diferencim ishte rezultat i disfatës së Gjermanisë në Frontin Lindor kundër BRSS, i ndikimit të Luftës Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë dhe të Shqipërisë, pastaj pasojë e ndryshimit të rrethanave lokale dhe aktivitetit të komunistëve.<sup>7</sup>

Të ngrihej kryengritja në Kosovë më 1941-1943 dhe të kërkosh nga shqiptarët që të bashkohen në një front të përbashkët antifashist me serbët (jugosllavët) ka qenë një idealizëm vizionar, naivitet, ose tradhti për masën e popullit, në kuptimin e gjerë. Të tria këto operacione ishin të mundshme. Më 1941 disa antifashistë (komunistë) shqiptarë do të shtronin pyetjen si mund të ndërtonin “vëllazërim - bashkimin” me serbët, kur populli e di fare mirë se çfarë kanë bërë serbët në mes dy Luftërave Botërore, duke ua mohuar të gjitha të drejtat kombëtare (pa të drejta politike dhe kombëtare, konfiskimin e tokës dhe pasurisë nga reforma agrare etj.).<sup>8</sup> I pari që do ta shtronte këtë pyetje ishte Emin Duraku, sipas të cilit popullata “e konsideronte komunizmin si pansllavizëm, njëjtë sikurse regjimin e mëparshëm reaksionar jugosllav”.<sup>9</sup> Pastaj këtij mendimi do t’i bashkohen Meto Bajraktari dhe Zenel Salihu. Me gjithë këto çështje delikate, falë punës vizionare të antifashistëve, arritën të bindnin popullatën se Lufta Nacionalçlirimtare nuk ishte thjesht një lëvizje komuniste, por lëvizje për liri nga fashizmi, që mbi gjakun e dëshmorëve të rinj do të lindë Kosova e lirë, ngase shumica e banorëve të saj është shqiptare, prandaj do t’i jepej mundësia të bashkohet me Shqipërinë e lirë.<sup>10</sup> Rrjedhimisht në Kosovë do të formohen këshilla ilegale nacionalçlirimtare, do të formohen çeta dhe batalione e pastaj edhe aradhe partizane nacionalçlirimtare, kryesisht të përbëra nga shqiptarët antika-shitë. Kështu do të formësohen dy hallka të rreshtimit antifashist edhe në

<sup>6</sup> Ali Hadri, “Sistemi i pushtimit fashist në Kosovë (1941-1944), *Kosova*, Nr. 7, (1978), 52.

<sup>7</sup> Ali Hadri, *Lëvizja Nacional Çlirimtare në Kosovë 1941-1945*, (Prishtinë: 1971), 190.

<sup>8</sup> *Agjencia Shtetërore e Arkivave të Kosovës (më tej:ASHAK)*, Fondi: Komiteti Krahinor i Lidhjes Komuniste të Kosovës, Njësia organ: Fondi i K.N.Ç, Viti. 1945, Nr. i kutisë:23, fl.4.

<sup>9</sup> *Po aty*, Fondi: Komiteti Krahinor i Lidhjes Komuniste të Kosovës, Njësia organike: Komiteti i Vendit Gjakovë, Viti: 1942-1944, Nr.i kutisë: 31, fl.1.

<sup>10</sup> *Po aty*, Fondi: Komiteti Krahinor i Lidhjes Komuniste të Kosovës, Njësia organike: Kopjet e gazetës “Zëri: dhe “Lirija”, Viti: 1942-1963, Nr. i kutisë:39, fl.36.

Kosovë; ajo e pushtetit ilegal dhe ajo e ushtrisë nacionalçlirimtare partizane. Kjo luftë ndryshonte nga ato të deritashme, pasi kjo do të lidhej ngushtë me aleatët antifashistë (Britaninë e Madhe, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Sovjetik).<sup>11</sup>

Në fillimet e saj, Lëvizja Antifashiste në Kosovë filloi me aksione të ndryshme; duke filluar me prerjen e shtyllave telefonike, prishjen e rrugëve, si dhe me organizimin e demonstratave antifashiste.<sup>12</sup> Kjo vepërimitari vazhdoi me themelimin e aradhes së parë partizane “Zejnel Hajdini”, në krye me Xheladin Kurbaliun si komandant dhe Fadil Hoxhën si komisar.<sup>13</sup> Organizimi, zhvillimi dhe masivizimi i rinisë në Lëvizjen Antifashiste në Kosovë ka qenë i frymëzuar nga ndjenjat patriotike dhe në rrethana lokale specifike dhe të vështira (ndarja e Kosovës në tri zona okupuese, politika demagogjike e okupatorit, iluzioni në një pjesë të masave shqiptare në lidhje me çlirimin, disponimi antijugosllav, kundërtëhëniet kombëtare, frika nga kthimi i së vjetrës. Edhe përkundër këtyre pengesave, Lëvizja Antifashiste Nacionalçlirimtare e Kosovës ia doli të fitojë besimin e popullit dhe të lëshojë rrënjë të thella në familjet shqiptare. Në Kosovë gjatë viteve 1941-1945 do të formohen shumë çeta partizane. Ato me kohë do të ngrihen në batalione dhe aradhe partizane nacionalçlirimtare. Këto njësi partizane do të bëjnë luftë guerile dhe rralleherë frontale me okupatorin. Aradhet dhe brigadat që do të formohen gjatë vitit 1944 do të orientohen kryesisht në luftë frontale me okupatorin dhe ndihmësit e tij. Në këto rrethana do të kontribuojnë këshillat ilegale nacionalçlirimtare, të cilat në fund të vitit 1943 do të rezultojnë me formimin e një Këshilli të përbashkët Nacionalçlirimtar, i cili do ta faktorizojë Kosovën fuqishëm në luftën e përbashkët me koalicionin antihitlerian.

Lëvizja antifashiste, pasi forcoi pozitën e saj ushtarake e politike, që ishte rezultat i dobësimit dhe shpërndarjes së potencialit ushtarak fashist nëpër fronte të ndryshme,<sup>14</sup> por edhe të faktit se po fillonte të qartësohej fundi i Luftës së Dytë Botërore, ndikoi shumë në zgjerimin e LNÇ-së, me

<sup>11</sup> *Po aty*, fl.12.

<sup>12</sup> Qamil Gexha, “Demonstratat antifashiste në Gjakovë gjatë Lëvizjes Nacionalçlirimtare (1941-1943)”, *Kosova*, Nr.2, (1973),123.

<sup>13</sup> Vahide Hoxha, “Aradha partizane “Zejnel Hajdini”, *Kosova*, Nr.9-10, (1980/81),108.

<sup>14</sup> *ASHAK*, Fondi: Komiteti Krahinor i Lidhjes Komuniste të Kosovës, Njësia organike: Kopjet e gazetës “Zëri dhe “Lirija”, Viti: 1942-1963, Nr. i kutisë:39, fl.1.

shpresën se pas luftës do të zgjidhej edhe çështja kombëtare.<sup>15</sup> Në këtë frymë, Fadil Hoxha propozoi që të mbahej Konferenca në fshatin Bujan të Malësisë së Gjakovës (31 dhjetor 1943-1, 2 janar 1944), ku kjo zonë kishte baza të sigurta dhe mbështetjen e popullsisë vendase.<sup>16</sup> Pika më e rëndësishme e kësaj konference ishte vendimi, sipas së cilës, populli shqiptar i Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit, shprehte vullnetin e tij të lirë që t'i bashkohet shtetit amë – Shqipërisë.<sup>17</sup> Ky vendim ishte plotësisht në përputhje me Kartën e Atlantikut, që shprehte qartë “të drejtën e popujve për vetëvendosje dhe kërkonin t’u rijepnin pavarësinë atyre që ishte privuar”.<sup>18</sup>

Ideja për formimin e Këshillit Krahinor Nacionalçlirimtar për Kosovën lindi qysh në dhjetor të vitit 1942, pas mbledhjes së parë të AVNOJ-it (Antifaštičkog vijeća narodnog oslobođenja Jugoslavije) në Bihaç dhe e përkrahur nga Boro Vukmiroviç (sekretarit të Komitetit Rajonal të Partisë Komuniste të Jugosllavisë për Kosovën dhe Metohinë) dhe nga Ramiz Sadiku. Kjo ide u aktualizua në shkurt të vitit 1943, por me vrasjen e këtyre dy veprimtarëve çështja u shty për më vonë. Pas kapitullimit të Italisë në shtator të vitit 1943 filloi të flitej për Këshillin e Përkohshëm Nacionalçlirimtar. Gazeta “Liria”, në një artikull të saj të shkruar nga Fadil Hoxha, dënonte Lidhjen e Dytë të Prizrenit dhe paralajmëronte Konferencën e popujve të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit e cila do të kishte rëndësi më të madhe se Lidhja e Prizrenit (1878).<sup>19</sup> Vendimi për mbajtjen e Konferencës u mor gjatë Këshillimit VI të Komitetit Krahinor të Partisë Komuniste të Jugosllavisë për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit, që u mbajt në malet e Sharrit në datat 3-5 nëntor 1943.<sup>20</sup> Me anë të kësaj konference shqiptarët shprehnin vullnetin e tyre, që përkundër faktit se Lëvizja Çlirimtare në Kosovë ishte nën drejtimin e PKJ-së, u përpoq të ishte e autonome në vendime, si dhe nacionalçlirimtare në kuptimin e plotë dhe e pavarur nga strukturat dhe

<sup>15</sup> *Historia e Shqipërisë dhe e shqiptarëve*, Redaktor përgjegjës: prof. dr. Hysni Myzyri, (Prizren: Sprint, 2001), 308.

<sup>16</sup> Muharrem Dezhgiu, “Operacioni gjerman në Malësinë e Gjakovës”, *Konferenca e Bujanit (përmbledhje studimesh)*, (Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë, 1998), 85.

<sup>17</sup> Ekrem Murtezai, *Fadil Hoxha siç e njoha unë*, (Prishtinë: Shtëpia botuese “Libri shkollor”, 2011), 79.

<sup>18</sup> Liri Shimani, “Konferenca e Bujanit dhe Karta e Atlantikut”, *Konferenca e Bujanit (përmbledhje studimesh)*, (Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë, 1998), 53.

<sup>19</sup> Sami Repishti, “Rezoluta e Bujanit- 2 janar 1944 një analizë”, *Studime historike*, Nr. 1-4(1995), 90.

<sup>20</sup> *Po aty*.

instancat serbe e jugosllave dhe, natyrisht, e lidhur me Shqipërinë.<sup>21</sup> Përkërisht për këto arsye, në prag të mbajtjes së Konferencës së Bujanit, Svetozar Vukmanoviç-Tempo tërhoqte vërejtjen mbi gjoja rënien e udhëheqjes politiko-ushtarake të Kosovës nën ndikimin nacionalist dhe e akuzonte atë se po zbatonte “në të vërtetë linjën shqiptaromadhe”.<sup>22</sup>

Aty nga fundi i vitit 1943 dhe fillimi i vitit 1944 pati një dinamikë të shtuar të veprimtarisë në radhët e Lëvizjes Nacionalçlirimtare të Kosovës. Udhëheqja e saj vendosi të thërriste Konferencën themeluese të Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit. Shqiptarët e Kosovës po bindeshin çdo ditë e më shumë, se nga PKJ nuk mund të pritej zgjidhja e çështjes së tyre kombëtare. Në të vërtetë, një muaj para se të thirrej Konferenca e Bujanit, në Jajce (Bosnjë dhe Hercegovinë) u mbajt mbledhja e dytë e AVNOJ-it (Këshillit Antifashist Nacionalçlirimtar të Jugosllavisë), në të cilën u vendos që pas luftës të krijohet Jugosllavia si shtet federativ (ku përfshiheshin: Serbia, Kroacia, Bosnja-Hercegovina, Mali i Zi, Maqedonia dhe Sanxhaku), ndërsa në pikën e katërt theksohej se pakicave kombëtare do t’u siguroheshin të drejtat kombëtare.<sup>23</sup> Kjo do të thoshte se me pikën e katërt të këtij vendimi, hidheshin poshtë premtimet dhe propagandën e deriatëhershme të PKJ-së, sipas së cilës, pas luftës, popujt që jetonin në ish-Monarkinë e Jugosllavisë, do të vendosnin vetë për të ardhmërinë e tyre.<sup>24</sup> Dhe kjo i shqetësoi shqiptarët, të cilët po bindeshin se nuk mund të ecej më me iluzione, se situata nuk mund të përballohej duke qëndruar duarlidhur përballë faktit se po injorohej çështja kombëtare shqiptare, madje nuk po trajtohej as si komb, por si “pakicë kombëtare”.<sup>25</sup> Në këto rrethana organizimi i Konferencës shihej si hapi i parë i domosdoshëm për zgjidhjen e këtij problemi. Gjatë përgatitjeve për mbajtjen e Konferencës dolën mjaft

<sup>21</sup> Fehmi Agani, “Konferenca e Bujanit dhe mëvetësia e Kosovës”, *Konferenca e Bujanit (përmbledhje studimesh)*, (Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë, 1998), 10.

<sup>22</sup> Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, (Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë, 1997), 19.

<sup>23</sup> [http://www.arhivju.gov.rs/active/sr-cyrillic/home/glavna\\_navigacija/leksikonjugo\\_slavije/konstitutivni\\_akti\\_jugoslavije/deklaracija\\_drugog\\_zasedanja\\_avnoja.html](http://www.arhivju.gov.rs/active/sr-cyrillic/home/glavna_navigacija/leksikonjugo_slavije/konstitutivni_akti_jugoslavije/deklaracija_drugog_zasedanja_avnoja.html). Qasja më 18 nëntor 2021.

<sup>24</sup> Sadik Bekteshi, “Konferenca e Bujanit”, *Konferenca e Bujanit (përmbledhje studimesh)*, (Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë, 1998), 143.

<sup>25</sup> Xhelal Gjeçovi, “Rezoluta e Bujanit aspiratë e popullit shqiptar”, *Konferenca e Bujanit (Materiale nga Sesioni Shkencor kushtuar 55 vjetorit të Konferencës së Bujanit, mbajtur në Tiranë më 20 janar 1999)*, (Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë: Instituti i Historisë, 1999), 8.

vështirësi. Disa grupime nga radhët e nacionalistëve shqiptarë nuk u shprehën të gatshëm të merrnin pjesë në këtë Konferencë, me arsyen se platforma e PKJ-së nuk garantonte zgjidhjen e problemit të shqiptarëve. Vështirësi dolën edhe nga qëndrimet e komunistëve serbë e malazez në Komitetin Krahinor të Kosovës.<sup>26</sup> Konferenca e organizuar nga Fronti Antifashist Nacionalçlirimtar i Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit i filloi punimet në fshatin Bujan, më 31 dhjetor të vitit 1943 dhe punimet i vazhdoi edhe më 1 dhe 2 janar 1944.<sup>27</sup>

U arrit pëlqimi që në konferencë të përfaqësoheshin të gjitha rajonet, shtresat dhe kombësitë e Kosovës. Konferenca u mbajt në fshatin Bujan të Malësisë së Gjakovës, pasi në Kosovë nuk kishte ende zonë të lirë,<sup>28</sup> si dhe për faktin se kjo krahinë kishte dhënë kontribut të rëndësishëm në organizimin dhe zhvillimin e Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Kosovë.<sup>29</sup> Konferenca i zhvilloi punimet në kullën e Sali Manit, bajraktarit të Krasniqes, që ndodhej pranë bazës së Shtabit Krahinor të Ushtrisë Nacionalçlirimtare të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit dhe të Komitetit Krahinor të PKJ. Në këtë kohë kjo kullë ishte shndërruar në njërën nga bazat më të sigurta të Lëvizjes Antifashiste dhe ishte pikëmbështetje e fuqishme midis trekëndëshit Gjakovë-Malësi-Plavë.<sup>30</sup> Në Konferencë ishin të ftuar 61 delegatë, por morën pjesë vetëm 49 prej tyre. Në mesin e të ftuarve ishte edhe përfaqësuesi anglez, Hendsi, i cili kishte shprehur entuziazmin dhe përkrahjen e tij për organizimin e konferencës.<sup>31</sup> Në dhomën ku u zhvillua mbledhja nuk u vendosën as flamuj, as parulla e as shenja të tjera dalluese, me qëllim që të mos prekej askush. Ky dekor i thjeshtë i përgjigjej përbërjes së delegatëve dhe qëllimit të ardhjes së

<sup>26</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV. 2008, 141.

<sup>27</sup> *ASHAK*, Fondi: Komiteti Krahinor i Lidhjes Komuniste të Kosovës, Fondi i Shtabit të Këshillave Nacionalçlirimtar, Viti 1944, Nr. i kutisë 23, Nr i Inv. 1329, Rezolucion nga Konferenca e parë e Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit e mbajtur më 31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar 1944, Nr. 1329, fl.1-7.

<sup>28</sup> Mark Palnikaj, *Konferenca e Bujanit 31 dhjetor 1943-2 janar 1944*, (Tiranë: Grand Prind, 2006), f. 5: *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV 2008, 142.

<sup>29</sup> Tahir Mala & Myftar Memia, "Disa momente të Luftës Nacionalçlirimtare në Malësinë e Gjakovës dhe ndihma e saj për zhvillimin e Lëvizjes Nacionalçlirimtare në Kosovë", *Studime historike*, Nr.1, (1970), 47.

<sup>30</sup> Jusuf Bajraktari, "Jah Salih Mani (1921-1944)", *Në flakën e revolucionit*, libri i tetë, (Prishtinë: Instituti i Historisë së Kosovës, 1980), 172.

<sup>31</sup> *ASHAK*, Fondi: Komiteti Krahinor i Lidhjes Komuniste të Kosovës, Njësia organ: Komiteti i Vendit Gjakovë, Viti: 1942-1944, Nr. i kutisë: 31, fl.1.

tyre.<sup>32</sup> Konferencën e përshëndetën Fadil Hoxha, komandant i Shtabit Kryesor të UNÇ për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit, në emër të rinisë ka folur Xhafer Vokshi, ndërsa në emër të grave antifashiste Sabrije Vokshi. Konferencës i janë drejtuar edhe Mehmet Bajraktari i Krasniqes (Shqipërisë) si dhe Xhevdet Doda delegat i Brigadës Kosovare-Maqedonase.<sup>33</sup> Pas përshëndetjeve të rastit nga kryesitë e organizatave të ndryshme pjesëmarrëse u zgjodh Kryesia e Nderit e përbërë nga zotërinjtë Ruzvelt, Çerçill, Stalin dhe Enver Hoxha.<sup>34</sup>

Konferenca u dha fund punimeve duke krijuar Këshillin Nacionalçlirimtar të Kosovës, si organin më të lartë të pushtetit në Kosovë. Në Kryesi u zgjodhën: Mehmet Hoxha, Rifat Berisha, Pavle Joviçević, Zekeria Rexha, Xhevdet Doda, Millan Zeqar, Fadil Hoxha Ali Shukriu, Hajdar Dushi.<sup>35</sup> Nga 49 delegatë të pranishëm, 32 prej tyre nuk ishin anëtar të asnjë partie, por përfaqësonin Frontin Antifashist. Ndërsa të tjerët ishin anëtarë të PKJ-së dhe përfaqësonin anëtarësinë e tyre nga të gjitha viset e Kosovës.<sup>36</sup>

Në fillim të diskutimeve, Mehmet Hoxha lexoi referatin e tij me titull “Situata politike dhe formimi i Këshillit Nacionalçlirimtar”, në të cilin arsyetoi pjesëmarrjen e vogël të shqiptarëve në LNÇ, me frikën dhe mosbesimin e tyre ndaj bashkëpunimit me serbo-malazeztë. Shqiptarët kishin qenë të shtypur jo vetëm politikisht, ekonomikisht, por edhe si kombësi e përndjekur nga aparati represiv serb. Në fund të diskutimit, Mehmet Hoxha ka ftuar të gjithë ata, të cilët nuk i kanë të përlyera duart me gjakun e popullit, që të marrin pjesë në frontin e përbashkët antifashist. Ndërsa, Xhavit Nimani, në referatin e tij, ka qenë i fokusuar në përgjithësi në detyrat dhe nevojën e forcimit të luftës kundër okupatorit.<sup>37</sup>

Pas përfundimit të diskutimeve mbi raportet e paraqitura, u kalua në procedurën e miratimit të dokumenteve të Konferencës, të Rezolutës

<sup>32</sup> Xhelal Gjeçovi, *Kosova në relacionet shqiptaro-jugosllave në vitet e Luftës së Dytë Botrore (1939-1944)*, (Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë, 2020), 254.

<sup>33</sup> Hysen Azemi, *Mbledhja e Bujanit dhe kuslinget sipas autorve serbe*, (Materiali në dorshkrim), f. 7.

<sup>34</sup> Mark Palnikaj, *Konferenca e Bujanit 31 dhjetor 1943-2 janar 1944*, (Tiranë: Grand Prind, 2006), f. 6.

<sup>35</sup> “Konferenca e Bujanit”, (*përmbledhje studimesh*), (Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë, 1998), 194-195.

<sup>36</sup> Hakif Bajrami, *Kosova prej Bujanit deri në Kaçanik*, (Prishtinë 1997), 123.

<sup>37</sup> Hysen Azemi, *Mbledhja e Bujanit dhe kuslinget sipas autorve serbe*, (Materiali në dorshkrim), f. f.7-8.

dhe të Deklaratës drejtuar popullit të Kosovës.<sup>38</sup> Në hartimin e Rezolutës së Bujanit u angazhuan: Zekeria Rexha dhe Hajdar Dushi, ndërsa Mehmet Hoxha, Pavle Jovaçević, Selman Riza, Fadil Hoxha, ndihmuan dy autorët e lartcekur.<sup>39</sup> Platforma politike e Rezolutës së Bujanit përcaktonte qëndrimet e saj, sipas së cilës shqiptarët e Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit, si gjithmonë në të kaluarën, ashtu edhe sot dëshirojnë bashkimin me Shqipërinë. Rruga më e mirë për shqiptarët që të bashkohen me Shqipërinë është lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë kundër pushtuesit dhe shërbëtorëve të tyre. Populli shqiptar i Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit, me angazhimin e tij në luftë kundër pushtuesit, do të fitojë të drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputje. Kjo e drejtë garantohet nga Lufta Nacionalçlirimtare e Jugosllavisë,<sup>40</sup> Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë, Aleatët Antifashistë (Bashkimi Sovjetik, Britania e Madhe dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës) dhe e mbështetur në Kartën e Atlantikut dhe të Konferencave të Moskës e të Teheranit.<sup>41</sup> Proklamata e konferencës iu dërgua Komitetit Krahinor të Kosovës dhe Dukagjinit, me detyrë që deri më 10 shkurt të vitit 1944 t’iu shpërndahet të gjitha rajoneve.<sup>42</sup>

Me Rezolutën e Bujanit si dhe me pjesëmarrjen në luftën antifashiste, populli shqiptar i Kosovës dhe i Rrafshit të Dukagjinit rreshtohet përkrah koalicionit antihitlerian. Ky qëndrim dhe kjo luftë e drejtë ua prishte planet dhe programet qarqeve nacionaliste serbe, duke ua pamundësuar atyre shfrytëzimin (si argument të politikave antishqiptare) e akuzës se ata ishin bashkëpunëtorë të fashizmit. Mirëpo, gjatë Luftës së Dytë Botërore ngjeshja e radhëve antifashiste kombëtare dhe ndër-kombëtare u bë mbi bazë të proklamimit dhe garantimit të të drejtave në

<sup>38</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. IV 2008, 142-143.

<sup>39</sup> Vehap Shita, “Hajdar Dushi - njëri nga sajuesit e rezolutës së Konferencës së Bujanit”, *Hajdar (Beg) Dushi jeta dhe veprimtaria patriotike e heroit të popullit* (përmbledhje kumtesash të përgatitura nga Minir (Beg) Dushi), ( Prishtinë: Shoqata e Veteranëve të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare të Kosovës dhe Shoqata e Intelektualëve “Jakova”, Gjakovë, 2012), 88.

<sup>40</sup> ASHAK, Fondi: Komiteti Krahinor i Lidhjes Komuniste të Kosovës, Fondi i Shtabit të Këshillave Nacionalçlirimtarë, Viti.1944, Nr i kutisë 23, Nr. i Inv. 1329, Rezolucion nga Konferenca e parë e Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovë e Rrafsh të Dukagjinit e mbajtur më 31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar 1944, Nr. 1329, fl.1.

<sup>41</sup> Sami Repishti, “Rezoluta e Bujanit- 2 janar 1944 një analizë”..., 90.

<sup>42</sup> ASHAK, Fondi: Komiteti Krahinor i Lidhjes Komuniste të Kosovës, Njësia organ: Komiteti Vendit Gjakovë, Viti.1940-1944, Nr. i kutisë:30, fl.1.

vetëvendosje të të gjithë popujve pjesëmarrës në bllokun antifashist.<sup>43</sup> Ndërkohë komunistët serbë dhe malazez (Millovan Gjillasi, Aleksandar Rankoviqi dhe Svetozar Vukmanoviq - Tempo) nxituan që të dënojnë vendimet e Konferencës së Bujanit, duke i delegitimuar kërkesat politike të shqiptarëve të mbetur jashtë kufijve të Shqipërisë “Londineze”. Letra e Millovan Gjilasit, e 28 marsit të vitit 1944 ( e shkruar në emër të KQ të PKJ), ndonëse e shkruar me mjeshtëri, godiste nervin kryesor të Rezolutës, duke qortuar pjesën e tekstit që pasqyrore aspiratat e popullit shqiptar të Kosovës për t’u bashkuar me Shqipërinë.<sup>44</sup> Ndërsa, duke i akuzuar shqiptarët si profashistë, do të pasojnë veprime të tjera me qëllim të defaktorizimit të Kosovës dhe të shqiptarëve, me synimin përfundimtar të anulimit të Rezolutës së Bujanit.<sup>45</sup>

Miratimi i njëzëshëm i dokumenteve të Konferencës, jehona që ngjalli në popull si dhe fryma toleruese e bashkëpunimi i delegatëve, janë argumente të fuqishme se Konferenca e Bujanit ishte pa dyshim kuro-rëzim i sukseseve të arritura e rezultat logjik i zhvillimit të LANÇ-së, si dhe shprehje e programit të përhershëm të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare.<sup>46</sup> Rrjedhimisht Konferenca e Bujanit ndikoi në popullarizimin e Lëvizjes Nacionalçlirimtare si dhe për përvetësimin e masave shqiptare të Kosovës për vijën e LANÇ-së.<sup>47</sup> Me një fjalë ajo kishte të njëjtën rëndësi në historinë shqiptare ashtu sikur: Kuvendi i Lezhës (1444), Lidhja e Prizrenit (1878), Kongresi i Lushnjës (1920) etj.<sup>48</sup> Shtruarja dhe kërkesa për realizimin e së drejtës për vetëvendosje deri në shkëputje ishte në pajtim të plotë me aktet ndërkombëtare, si dhe me frymën e ideologjisë komuniste, e cila proklamonte barazinë kombëtare dhe të drejtën për

<sup>43</sup> Muhamet Pirraku, “Vetëvendosja e Kosovës në dritën e lëvizjes antifashiste”, *Gjurmime albanologjike*, Nr.21, (1993), 8.

<sup>44</sup> Zekeria Cana, “Mbledhja e Mukjes, Lidhja e Dytë e Prizrenit, Konferenca e Bujanit dhe Çështja e Bashkimit Kombëtar”, *Studime historike*, Nr.1-4, (1992), 102.

<sup>45</sup> Seit Lipa, “Rezoluta e Bujanit dhe atakimi saj nga ideologjia shtetërore serbe”, *Gjurmime albanologjike*, Nr. 22, (1994),145.

<sup>46</sup> Marenglen Verli, “Politika ekonomike e Jugosllavisë në Kosovë pas Luftës së Dytë Botërore”, *Konferenca e Bujanit (Materiale nga Sesioni Shkencor kushtuar 55-vjetorit të Konferencës së Bujanit, mbajtur në Tiranë, më 20 janar 1999)*, (Tiranë: Akademia e Shkencave e Republikës së Shqipërisë: Instituti i Historisë, 1999), 102.

<sup>47</sup> Fehmi Rexhepi, “Vendimet e Konferencës së Bujanit-frymëzim për pjesëmarrje aktive të shqiptarëve të Kosovës në luftën çlirimtare antifashiste”, *Konferenca e Bujanit (përmbledhje studimesh)*, (Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë, 1998), 36-38.

<sup>48</sup> ASHAK, Fondi: Komiteti Krahinor i Lidhjes Komuniste të Kosovës, Njësia organike: Kopjet e gaxetës “Zëri dhe “Lirija”, Viti: 1942-1963, Nr. i kutisë:39, fl.38.

vetëvendosje. Legjislacioni ndërkombëtar ua njuh kombeve të drejtën e vetëvendosjes, ndërsa institucionet ndërkombëtare e njohin atë vetëm pasi kombet ta kenë fituar. Pra, kjo do të thotë se kombet nuk garantohen për të drejtën e vetëvendosjes, por në të njëjtën kohë nuk pengohet mundësia e zbatimit të saj.<sup>49</sup> Vendimet e Konferencës së Bujanit nuk janë të rëndësishme vetëm nga aspekti historik, por edhe për ardhmërinë e popullit shqiptar. Kjo lidhje organike e së kaluarës dhe ardhmërisë politike të shqiptarëve pasqyrohej në statusin politik të Kosovës. Sa herë evoluonte statusi i Kosovës, Konferenca e Bujanit do të merrej si referenca kryesore e mëvetësisë së saj, e sa herë minimizohej statusi i Kosovës, do të goditej pikërisht edhe Konferenca e Bujanit.<sup>50</sup>

Si përfundim, Konferenca e Bujanit shënon një moment të rëndësishëm për shqiptarët e Kosovës. Përmes saj u përçua vullneti i popullit të Kosovës dhe rreshtimi i tij përkrah aleatëve antifashistë, si garancia e vetme për liri dhe bashkim të shqiptarëve.<sup>51</sup> Mirëpo, ishin ndërhyrjet e Shtabit të Përgjithshëm të Luftës Nacionalçlirimtare të Jugosllavisë ato që pamundësuan dhe bllokuan zbatimin e vendimeve të Konferencës së Bujanit, duke u përpjekur njëkohësisht për t'i shlyer nga kujtesa kolektive në të dyja anët e kufirit. Ndërsa çdo përpjekje për aktualizimin e saj ndëshkohej rëndë penalisht, si dhe bëhej përpjekje që të lihej në harrësë.<sup>52</sup> Vendimet e Konferencës së Bujanit konfirmuan se trevat e Kosovës dhe Rrafshit të Dukagjinit ishin me shumicë shqiptare dhe duhet t'i bashkoheshin Shqipërisë, duke shprehur qartë vullnetin e saj në mënyrë të natyrshme.

<sup>49</sup> Ana Lalaj, "E drejta e vetëvendosjes dhe shqiptarët e Kosovës (Vështrim i shkurtër historiko-juridik)", *Gjurmime albanologjike-SSH*, Nr.30, (2000), 26.

<sup>50</sup> Ana Lalaj, "Konferenca e Bujanit , 31 dhjetor 1943-2 janar 1944, një analizë e rivlerësuar", *Studime historike*, Nr. 3-4, (2011), 137.

<sup>51</sup> ASHAK, Fondi: Komiteti Krahinor i Lidhjes Komuniste të Kosovës, Njësia organike: Kopjet e gaxetës "Zëri dhe "Lirija", Viti: 1942-1963, Nr. i kutisë:39, fl.26.

<sup>52</sup> Ramiz Abdyli, "Kontributi i Sali Manit në mbarëvajtjen e punës së Konferencës së Bujanit", *Konferenca e Bujanit (përmbledhje studimesh)*, (Prishtinë: Instituti i Historisë-Prishtinë , 1998), 62.

## **BUJAN CONFERENCE CORNERSTONE OF KOSOVO STATEHOOD.**

### **Summary**

The National Liberation Movement in Kosovo, after strengthening its military and political position in the end of 1943, and as it became increasingly clear that the end of World War II was approaching, Fadil Hoxha, one of the leading figures of the Anti-Fascist Movement in Kosovo, proposed that the Bujan Conference to be held on 31 December 1943 and 1 and 2 January 1944 in the village of Bujan in the Gjakova Highlands. The most important thing, on the basis of which this conference is mentioned, is that it conveyed the will of the people of Kosovo and its alignment with the anti-fascist allies. The resolution, which, among other things, states that the Albanian people of Kosovo and the Dukagjini Plain, expresses its free will that after the war, Kosovo joins the mother country - Albania. The Bujan Conference and its decisions have a special importance in the Albanian history, as they became the points of support and the most important and legitimate arguments of the demands of the Albanians for the independence of Kosovo and self-determination.